

KALENDARI I FESTAVE DHE AKTIVITETEVE / BASHKIA BELSH						
MUAJI	AKTIVITETI	PËRSHKRIMI	KU	KUR	TIPOLOGJIA	Nr.KONTAKT I
JANAR	-	-	-	-	-	067436884 98
SHKURT	Festivali i Ushqimit	Në qytetin tonë zhvillohet “ Festivali i Ushqimit në Liqenin Seferan, Belsh”, një event që synon të promovojë dhe të zhvillojë turizmin në zone me vlera të veçanta natyrore, por edhe me tradita kulturore. Panairi i Ushqimit që bëhet ne Belsh është një shprehje qe tregon që zona ka mundësi për të promovuar turizmin dhe produktet e saj. Në një atmosferë shumë festive ekspozohen dhe shijohen dhe disa gatime tradicionale të zones.	Seferan, Belsh	3 Shkurt	Traditë Promovim	
MARS	Panairi me rastin e Festës së Ditës se Veres Dita Ndërkombetare e Ujit	Nxënësit e Gjimnazit “Sami Frashëri” Belsh organizojnë Panairin me rastin e Dites së Verës duke promovuar produktet tradicionale të zones së Belshit, duke trashëguar kështu traditen e kësaj feste. Ky aktivitet u zhvillua për herë të parë në Belsh në kuadër të ditës ndërkombëtare të ujit dhe mbështetur nga Projekti “Bashkitë për Evropë” të financuar nga Bashkimi Evropian.	Seferan dhe Belsh	14 Mars 21 Mars	Trashëgimi Promovim	

PRILL	Festa e Balonave	<p>Bashkia e Belshit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit organizon cdo vit Festën e Balonave duke e kthyer atë një aktivitet masiv me nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe atyre të mesme. Aktivitet në të cilin marrin pjesë me qindra nxënës të shkollave të Bashkisë Belsh dhe zhvillohet në malin e Gradishtës. Ngritja e balonave është një garë mes nxënësve të shkollave të Bashkisë Belsh. Aktivitete të kësaj natyre janë të shumta me nxënësit e shkollave dhe ato nuk synohet që ti shërbejnë vetëm argëtimit dhe edukimit por edhe të tërheqin sa më shumë turistë në zonën e Belshit.</p>	Gradishtë, Belsh	27 Prill	Argëtim Tradite	
MAJ	Kolonia e Piktoreve	<p>Kolonia e piktorëve, u zhvillua për herë të parë në Belsh. 40 piktorë nga Shqipëria dhe jashtë saj u bënë pjesë e këtij aktiviteti. Piktoret për katër dite me radhë hodhën në telajo të gjitha peisazhet më të bukura të zonës së Belshit, (liqenet , kodrat , fushat , dhe qëndren e qytetit). Për piktorët, Belshi mbetet një studio e madhe, me hapësira për t'u eksploruar, befasuese për pasurinë natyrore që mbart, e cila është mjaft frymëzuese për të ushtruar talentin e tyre. Në ditën e fundit të aktivitetit , të gjithë piktorët ekspozuan punimet e tyre në sheshin e qytetit për të gjithë banorët.</p>	Në të gjithë zonën	18-22 Maj	Art Kreativitet Histori	

MAJ	Festa e Afërditës	<p>Bashkia Belsh në bashkëpunim me Tourism Investment and Finance Fund (TIFF) organizuan në bregun e liqenit piktoresk të Seferanit Festën e Afërditës. Ne ditën e parë të festës u promovuan aftësitë artistike të zërave të rinj, nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në shoqërinë civile, duke i socializuar dhe integruar me njëri-tjetrin, duke sjellur vlera të ndjeshme në jetën artistike të Dumresë dhe në gjetjen e standarteve bashkohore rekreative dhe edukuese nëpërmjet artit. Zhvillimi i Festës së Afërditës do të kthehet në një traditë të përvitshme dhe synon të promovojë gjurmë të qytetërimit të lashtë në këtë zonë, si dhe historinë e pasur të saj. Në feste u zhvillua “Miss Afërdita” me pjesëmarrjen e 20 bukurosheve nga qyteti dhe fshatrat e Bashkisë Belsh, u ushtrua kulti i Afërdites duke hedhur në liqenenë, terrakota, si dhurata për perëndinë ku qeramika me kokën e Afërditës zuri vend të veçantë.</p>	Seferan , Belsh	19-20 Maj		
QERSHOR	Jazz Festival	<p>Bashkia Belsh në bashkëpunim me Tourism Investment and Finance Fund (TIF),organizuan në mbremjen e 30 qershorit 2017 në pedonalen e qytetit Jazz Festival, me performues të njohur të kësaj fushe muzikore. Festivali u ndoq plot emocione nga qytetaret në Belsh.</p>	Belsh	30 Qershor	Muzikë	

KORRIK	-	-	-	-	-	
GUSHT	<p>Festivali Folklorik “Liqenet e Dumresë”</p>	<p>Në Bashkinë e Belshit cdo vit rradhazi zhvillohet Festivali Folklorik “Liqenet e Dumresë”. Në natën e parë në skenën e këtij Festivali ngjiten në skenë grupet Folklorike të Librazhdit, Lushnjës, Gramshit e Elbasanit, ndërsa në dy netët e tjera ngjiten në skenë grupet Folklorike të Shtërmenit, Strugës , Belshit e Kosovës, Tiranës, Fierit, Shkupit e Prizrenit. Ky festival është konceptuar në formën e një gare folklorike dhe në mbyllje të tij u shpërndanë çmime për grupet më të mira.</p>	Belsh	22-24 Gusht	Muzikë	
	<p>Maratona e Këngës Popullore</p>	<p>Maratona e Këngës Popullore , u zhvillua për herë të parë në Belsh. Këngëtarët më të njohur e më të preferuar për publikun shqiptar u ngjiten në skenë për të performuar për mijëra qytetarë të Belshit e jo vetëm. Koncerti u shoqerua me gëzim e valle nga të gjithë banorët e zonës së Belshit.</p>		21 Gusht		
SHTATOR	<p>Nimfa e Liqeneve</p>	<p>Promovimi i bukurive natyrore të liqeneve të Belshit, promovimin e kulturës,traditës,veshjeve popullore të zonës, promovimi i gatimeve dhe kulinarisë të zonës, prodhimeve bujqësore dhe blegtorale bio me qellim që të terheqim sa më shumë vizitorë për turizëm liqenore.</p>	Belsh Seferan	13-15 Shtator	Traditë dhe Trashgimi	

TETOR	Aktiviteti Miss Globe Beauty	Bashkia Belshi ne bashkpunim me regjizorin e mirënjohur të spektakleve z. Petri Bozo, dhe Fondin e Investimeve në Turizëm, organizoi " Miss Talent Show ", në kuadrin e Miss Globe 2017. Për herë të parë në Belsh u zhvillua një aktivitet i këtij lloji , ku 55 konkurente nga 5 kontinente të Globit , vizituan disa nga 84 liqenet e Belshit , ku në Liqenin Seferan zhvilluan nje tur me bicikleta dhe në mbrëmje performuan në pedonalen e qytetit Belsh me një paradë mbresëlënëse.	Në të gjithë zonën	25 Tetor	Bukuri	
NENTOR	Koncert me rastin e festave te 28-29 Nentorit	Bashkia Belsh ne bashkpunim me Shkollen e Mesme dhe 9-vjecare Belsh orgazojne cdo vit Koncert (Kenge , Valle , Recitime , Poezi), me rastin e festave te 28-29 nentorit ne Shtepine e Kultures Belsh.	Belsh	27-28 Nëntor	Muzikë	